FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 88 | 30 korrik | 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.423, datë 4.7.2012	Për miratimin e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm, 2013 – 2015.....	4431

VENDIM
Nr.423, datë 4.7.2012

PËR MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, 2013 - 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 25 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm, për periudhën 2013-2015, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PËRMBLEDHJE

Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2013-2015 përbën finalizimin e fazës së parë, të procesit të përgatitjes së kërkesave buxhetore afatmesme 2013-2015, proces ky i iniciuar përmes vendimeve të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kuadrit makrofiskal 2013-2015 dhe vendimit nr. 167, datë 29.2.2012 "Për miratimin e tavaneve të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2013-2015".

Si çdo vit i gjithë procesi është drejtuar dhe koordinuar nga grupi për menaxhimin strategjik (GMS), i cili është ngritur në çdo njësi të qeverisjes qendrore në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr. 78, datë 8.5.2006 "Për krijimin e grupeve ministrore të punës për strategji, buxhet dhe integrim, "GSBI"", të ndryshuar, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (nëpunësi autorizues/Sekretari i Përgjithshëm) në çdo njësi të qeverisjes qendrore. Në mënyrë të ngjashme, në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 29.3.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm" dhe udhëzimin nr. 7, datë 29.2.2012 "Për përgatitjen e PBA 2013-2015", është drejtuar dhe organizuar ky proces edhe në institucionet e tjera buxhetore.

Dokumenti i PBA-së 2013-2015 paraqet në detaje qëllimet, objektivat dhe produktet e programeve të secilës prej ministrive të linjës, për vitet 2013, 2014 dhe 2015. Kështu, ky dokument ka mundur të realizojë për një kuadër afatmesëm lidhjet mes qëllimeve dhe objektivave të politikave, me shpërndarjen e burimeve buxhetore, përkatësisht në nivel programi.

Është e rëndësishme për t'u theksuar fakti se, me rritjen progresive të vëmendjes kushtuar procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2013-2015, kapaciteti i menaxhimit po përmirësohet vazhdimisht me kalimin e kohës. Gjithashtu, sistemi i planifikimit të integruar dhe veçanërisht Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, janë bazat e forcimit të vazhdueshëm të procesit të PBA-së, nëpërmjet sigurimit të informacionit të nevojshëm në nivel strategjik të politikave.

Në vijim, dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2013-2015 është i strukturuar në tre kapituj:

- Kapitulli i parë përshkruan rolin e PBA-së si një instrument i menaxhimit të shpenzimeve publike, pjesë përbërëse e sistemit të planifikimit të integruar, si dhe termat kohorë që procesi i PBA-së ndjek gjatë vitit buxhetor;
- Kapitulli i dytë përshkruan kuadrin makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2013-2015;
- Kapitulli i tretë paraqet në mënyrë të përmbledhur informacionin e siguruar nga ministritë e linjës lidhur me kërkesat buxhetore afatmesme 2013-2015 dhe konkretisht qëllimet e politikës, objektivat dhe produktet për secilin prej programeve të tyre për vitet 2013, 2014 dhe 2015.

HYRJE

A.1 Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm

1. Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent kyç i sistemit të planifikimit të integruar. Ai është rezultat i dy proceseve: rishikimit të politikave dhe planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve të programit. Planet e shpenzimeve hartohen nga njësitë e qeverisjes qendrore brenda burimeve që Qeveria ka në dispozicion. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor.

2. Qëllimet kryesore të PBA-së janë:

- Inkurajimi i efektivitetit, eficencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike;
- Lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve strategjiko-politike të Qeverisë me shpërndarjen e burimeve publike dhe kryerjen e shpenzimeve publike;
- Promovimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal;
- Zgjerimi i vizionit të procesit buxhetor duke siguruar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare).

Dokumenti i PBA-së hartohet nga Ministria e Financave dhe i jep mundësinë Këshillit të Ministrave për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh brenda periudhës afatmesme që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve publike korente dhe kapitale.

Gjithashtu, ai u shërben njësive të qeverisjes qendrore dhe fondeve speciale të tyre, pasi mundëson përcaktimin prej tyre të politikave dhe programeve në një strukturë koherente, si dhe mundësinë për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen te programet prioritare në periudhën afatmesme.

Duhet theksuar, gjithashtu, që procesi i hartimit të PBA-së është i orientuar mbi bazën e performancës. Përparësitë e kësaj mënyre të re të konceptimit të planifikimit të shpenzimeve konsistojnë në përftimin e:

- Kontributit të qartë të produkteve në përmbushjen e objektivave të politikës;
- Produkteve të matshme;
- Aktiviteteve të kostueshme.

A.2 Programi Buxhetor Afatmesëm dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, me një horizont planifikimi prej 7 vitesh, përcakton strategjitë dhe synimet afatshkurtra dhe afatgjata për të gjithë sektorët, bazuar në një vizion kombëtar. Ky program do t'i shërbejë edhe arritjes së aspiratave të SKZHI-së për integrimin europian.

Për procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2013-2015, elementi strategjik i PBA-së u sigurua nëpërmjet konsultimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale përgjatë procesit të rishikimit të politikës së programit – përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave për çdo program buxhetor të ministrive të linjës. Ky proces u ndërmor nga një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Financave dhe departamentit të bashkërendimit të strategjive dhe koordinimit të ndihmës së huaj, në Kryeministri.

A.3 Procesi i përgatitjes së PBA-së 2013-2015

Tabela 1, paraqet në mënyrë të përmbledhur hapat kryesorë në procesin e përgatitjes së PBA-së 2013-2015, të ndërmarrë në përputhje me kalendarin e sistemit të planifikimit të integruar dhe kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2012 të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 915, datë 28.12.2011.

TABELA 1 FAZAT E PËRGATITJES SË PBA-SË

FAZAT	KOHA	PËRSHKRIMI
1. Kuadri makroekonomik, vendosja e prioriteteve dhe përgatitja e tavaneve të PBA-së për çdo njësi të qeverisjes qendrore dhe fondet speciale	Tremujori I	- Përgatitja e tavaneve të përgjithshme dhe vendosja e treguesve makroekonomikë përmes parashikimit makroekonomik - Identifikimi i prioriteteve të politikave dhe zërave me ndikim të rëndësishëm në shpenzime e të ardhura (pagat, transfertat vendore, programet e reja, projektet kryesore të investimeve publike) - Vendosja e tavaneve përgatitore të PBA-së - Përgatitja e udhëzimit për përgatitjen e PBA-së
Qeveria miraton parashikimin makroekonomik dhe fiskal, tavanet e përgjithshme dhe tavanet përgatitore të PBA-së 3-vjeçare për çdo njësi të qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre.		
2. Rishikimi i politikës së programit (RPP)	Tremujori II	- Njësitë e qeverisjes qendrore përcaktojnë politikat për çdo program dhe identifikojnë qëllimet dhe objektivat e programit
3. Planifikimi i shpenzimeve dhe investimeve të programit (PSHIP)	Tremujori II	- Brenda tavaneve të miratuara, njësitë e qeverisjes qendrore zhvillojnë PSHIP-në duke identifikuar produktet dhe duke i kostuar aktivitetet në bazë të fondeve në dispozicion për çdo program
Qeveria miraton projektdokumentin e PBA-së		
4. Përgatitja e buxhetit	Tremujori III	- Përgatitja e udhëzimit plotësues për përgatitjen e PBA-së. - Njësitë e qeverisjes qendrore paraqesin kërkesat buxhetore afatmesme të rishikuara
Qeveria miraton projektin e PBA-së të rishikuar dhe projektligjin e buxhetit vjetor dhe i dërgon në Kuvend përkatësisht për informim dhe miratim		
5. Shqyrtimi në Kuvend	Tremujori IV	- Shqyrtimi dhe miratimi i ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi
Shënim. Dokumenti përfundimtar i PBA-së publikohet në fillim të vitit pasardhës pas miratimit të ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi		

A.3.1 Rishikimi i politikës së programit (RPP)

Nevoja kryesore për një menaxhim efektiv të financave publike është përcaktimi i qartë i politikave. Për politikat e reja kjo mund të arrihet nëpërmjet zbatimit të një procesi të mirë të përcaktimit të politikave, domethënë nëpërmjet përmirësimit të hartimit të politikave.

Procesi i PBA-së merr një rëndësi parësore në përpjekjet e qeverisë për të lidhur buxhetin vjetor me politikat e tij. Për të arritur këtë, politikat duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të rishikohen rregullisht nëpërmjet një procesi të rishikimit të politikës së programit, i cili është i integruar me procesin e planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve, përcaktimit të kostove dhe përgatitjes së buxhetit.

A.3.2 Planifikimi i shpenzimeve dhe investimeve të programit (PSHIP)

Planifikimi i shpenzimeve dhe investimeve të programit është pjesë e planifikimit strategjik dhe pason rishikimin e politikës së programit. Ai përfaqëson pjesën kryesore të procesit të përgatitjes së PBA-së. PSHIP ndërmerret në kontekstin e politikës makroekonomike dhe veçanërisht të nevojës për stabilitet fiskal.

Ai realizohet gjithashtu në kontekstin e prioriteteve strategjike të Qeverisë dhe të qëllimeve dhe objektivave të politikës të përcaktuara për çdo sektor, domethënë, nëpërmjet rishikimit të politikës së programit, PSHIP-ja reflekton mënyrën se si Qeveria dëshiron t'i alokojë burimet e saj për secilin sektor.

Një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i PSHIP-së të jetë në përputhje me kuadrin makroekonomik e fiskal dhe prioritetet strategjike të Qeverisë, është vendosja e tavaneve të shpenzimeve, që përbën kufirin maksimal që mund të shpenzohet ose të planifikohet për t'u shpenzuar, për një qëllim të caktuar. PSHIP-ja ndërmerret nga ministritë e linjës, duke përdorur sistemin e informatizuar të Ministrisë së Financës për planifikimin e shpenzimeve dhe investimeve të programeve. Për njësitë e qeverisjes qendrore që nuk kanë akses në sistemin e informatizuar, planifikimi i shpenzimeve mundësohet nëpërmjet formateve përkatëse të përcaktuara në udhëzimin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm.

A.4 Roli i Ministrisë së Financave në procesin e PBA-së

Roli i Ministrisë së Financave përgjatë procesit të PBA-së është kryesor dhe shumë i rëndësishëm. Ministria e Financave gjatë fazës së rishikimit të politikës së programit, duhet të sigurojë që politikat, objektivat dhe qëllimet janë të përcaktuara qartë dhe se programet buxhetore dhe rezultatet e synuara do të plotësojnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon

vlerë për para që do të thotë përdorim të shpenzimeve publike në mënyrë ekonomike, eficente dhe efektive.

Ndërsa, roli i Ministrisë së Financave në fazën e planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve të programit është i dyfishtë.

i) Dërgon propozime për tavanet e përgjithshme të shpenzimeve dhe tavanet përgatitore të PBA-së në Këshillin e Ministrave;

ii) Analiza dhe vlerësimi nëse njësitë e qeverisjes qendrore po arrijnë eficencën, efektivitetin dhe ekonomi në përdorimin e fondeve buxhetore, gjë e cila mbahet në konsideratë gjatë propozimit të Tavaneve Përgatitore të PBA-së në Këshillin e Ministrave.

A.5 Roli i Komitetit të Planifikimit Strategjik

Komiteti i Planifikimit Strategjik është një strukturë e krijuar pranë Këshillit të Ministrave, e cila kryesohet nga Kryeministri. Roli i këtij Komiteti është thellësisht koordinues dhe vendimmarrës, pasi të gjitha propozimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me sistemin e planifikimit të integruar në përgjithësi dhe Programit Buxhetor Afatmesëm në veçanti, kalojnë detyrimisht për shqyrtim pranë këtij komiteti përpara se të marrin miratimin përfundimtar pranë Këshillit të Ministrave.

Në procesin e përgatitjes së PBA-së, Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe Këshilli i Ministrave luajnë një rol parësor në drejtim të miratimit të një sërë etapash të rëndësishme, të tilla si:

- Kuadri makroekonomik dhe fiskal për periudhën e PBA-së;
- Tavanet përgatitore dhe përfundimtare të PBA-së;
- Kalendari i sistemit të planifikimit të integruar;
- Projektdokumentin e PBA-së;
- Dokumentin e PBA-së të rishikuar.

B. Kuadri makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2013-2015

Kuadri fillestar makroekonomik e fiskal për periudhën 2013-2015 është pjesë e sistemit të planifikimit të integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave. Kuadri makroekonomik e fiskal përgatitet me qëllim që të ofrohet informacion për përcaktimin e përparësive strategjike, shpenzimeve agregate, synimeve në lidhje me të ardhurat dhe deficitin, si edhe për përcaktimin e tavaneve për të filluar procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) në nivel njësie të qeverisjes qendrore. Kuadri fillestar makroekonomik e fiskal miratohet nga Komiteti i Planifikimit Strategjik në muajin e parë të çdo viti dhe është subjekt rishikimi dhe përditësimi në dy momente kyç gjatë vitit; në muajin maj, përpara finalizimit të PBA-së dhe të tavaneve të PBA-së për shpenzimet dhe në muajin shtator, përpara dërgimit në Parlament të projektbuxhetit të shtetit.

Kuadri makroekonomik e fiskal për periudhën 2013-2015 përbëhet nga dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë paraqiten vlerësimet mbi zhvillimet ekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2013 dhe pjesa e dytë trajton parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomik, parashikimin e burimeve në dispozicion të qeverisë dhe shpërndarjen e tyre për periudhën 2013-2015.

ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Gjatë viteve të krizës ekonomike globale (2009-2011) stabiliteti makroekonomik në vend ka ndjerë presionet negative të saj, megjithatë është arritur të ruhet në parametra relativisht të kënaqshëm. Gjatë secilit prej viteve 2009-2011 u arrit të evitohej recensioni ekonomik, i cili u përjetua në pjesën dërrmuese të vendeve të rajonit dhe më gjerë, dhe ekonomia shqiptare vijoi të performojë me ritme pozitive rritje. Rritja mesatare ekonomike e Shqipërisë gjatë viteve 2000-2008 (periudha para krizës) ishte në nivelin 6.2%, duke qenë mbi mesataren prej 5.3% të vendeve të Europës Qendrore e Lindore (EQL), ndërsa norma e inflacionit mesatar për këtë periudhë ishte 2.7%, ndjeshëm poshtë mesatares prej 8.5% të vendeve të EQL-së. Gjatë viteve 2009-2011 (periudha e krizës globale) ekonomia e Shqipërisë ka performuar me një rritje mesatare prej rreth 3%, dukshëm mbi rritjen mesatare prej 0% të vendeve të EQL-së, ndërsa inflacioni mesatar ka qenë në nivelin 3.2%, lehtësisht poshtë inflacionit mesatar prej 3.7% të vendeve të EQL-së.

Një prej faktorëve përcaktues në evitimin e recensionit përgjatë goditjes së krizës globale, veçanërisht gjatë vitit 2009, ishte stimuli i fortë dhe efektiv i injektuar në ekonomi nëpërmjet një politike fiskale ekspansioniste, e cila u materializua kryesisht në një nivel të lartë investimesh publike, duke kompensuar rënien në kërkesën e jashtme dhe ngadalësimin e kërkesës së brendshme.

Në vitin 2010, politika fiskale u riorientua përsëri në një kurs të qëndrueshëm drejt konsolidimit të financave publike, ku deficiti fiskal u reduktua në 3.1% të produktit të brendshëm bruto (PBB) nga 7% e PBB-së që ishte në vitin 2009, ndërsa borxhi publik ra në nivelin 57.8% të PBB-së nga niveli 59.3% që ishte në vitin 2009. Në rrafshin relativ, mund të thuhet se politika fiskale e ndjekur gjatë viteve 2009-2011 ka rezultuar relativisht mjaft efektive, pasi në njërën anë vlerësohet si një prej faktorëve kyç në evitimin e një recensioni ekonomik dhe mbajtjen e ekonomisë në terren pozitiv, ndërsa nga ana tjetër zgjerimi i borxhit publik në raport me PBB-në për këtë periudhë tre-vjeçare ka rezultuar relativisht i ulët krahasuar me zgjerimin e borxhit publik të regjistruar në vendet e EQL-së. Borxhi publik i Shqipërisë nga viti 2008 në atë 2011 u rrit me 4.3 pikë përqindje të PBB-së, ndërsa zgjerimi i borxhit publik në vendet e EQL-së u rrit mesatarisht me 11.1 pikë përqindje të PBB-së.

Gjithashtu, të ardhurat e buxhetit të shtetit, në linjë me ecurinë e ekonomisë, janë prekur nga efektet negative të krizës globale, por sërish ato kanë regjistruar rritje pozitive përgjatë periudhës 2009-2011 dhe performanca e tyre ka qenë relativisht e kënaqshme krahasuar me vendet e EQL-së. Gjatë periudhës 2009-2011 të ardhurat e buxhetit janë rritur me mesatarisht 4.4% nga viti në vit, duke performuar mbi rritjen mesatare të të ardhurave të vendeve të EQL-së prej 2.9%. Gjatë periudhës 2009-2011 shpenzimet kapitale janë mbajtur në nivele relativisht të larta dhe përpjesa e tyre e financuar me të ardhurat e veta dhe privatizime ka vijuar të jetë qartësisht pozitive.

Sektori real Më 2011-ën ekonomia shqiptare vazhdoi të përjetonte një rritje pozitive, e cila vlerësohet të jetë rreth 3.1 për qind. Zhvillimeve të pafavorshme të ambientit të jashtëm dhe pasiguritë në rritje të agjentëve ekonomikë penguar rritjen ekonomike për të qenë në potencialin e saj të plotë. Aktiviteti ekonomik është ngadalësuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 me rritjen më të ulët të regjistruar në tremujorin e dytë dhe rimori një forcë gjatë gjysmës tjetër të vitit, sidomos në tremujorin e fundit. Rritja ekonomike në vitin 2011 u gjenerua kryesisht nga kërkesa e brendshme, pothuajse në mënyrë të barabartë ndërmjet investimeve dhe të konsumit, ndërsa kontributi i kërkesës së jashtme ishte modest, veçanërisht në qoftë se krahasohet me rolin e kërkesës së jashtme gjatë vitit 2010. Sektori i "transportit" ka udhëhequr aktivitetin ekonomik gjatë vitit 2011 me një rritje reale prej rreth 18.2 për qind, pasuar nga "tregtia" dhe "industria" në rritje në terma realë respektivisht prej rreth 5.4 për qind dhe 3.6 për qind. Gjatë vitit 2011, kontribut pozitiv dha dhe sektori i "bujqësisë" me një rritje reale prej rreth 2.9 për qind. Sektori "i ndërtimit" u kthye në rritje pozitive prej rreth 0.4 për qind, pas gati dy vjet rresht tkurrje të thellë.



Kushtet e tregut të punës janë përmirësuar disi në tremujorët e fundit të 2011-ës, pas ngërçit në T-1 të po këtij viti, duke pasqyruar rimëkëmbjen në aktivitetin ekonomik. Punësimi në sektorin privat jobujqësor u rrit me 9.5 % në terma vjetore në T-2 të 2011-ës dhe vazhdoi të rritet me 0.4 % dhe 2.5 % në T-3 dhe T-4 të po këtij viti. Përmirësimi i punësimit në sektorin privat jobujqësor ka reflektuar kryesisht rritje të numrit të të punësuarve në industri dhe në sektorët e shërbimeve. Këta janë sektorët me performancën më të mirë në aspektin e rritjes së vlerës së shtuar. Në të kundërt, të punësuarit në sektorin e ndërtimit regjistruan një rënie.

Totali i punësimit në sektorin privat (me përjashtim të sektorit bujqësor) është rritur nga 4,120 persona gjatë T-1 të 2011-ës, në krahasim me tremujorin paraardhës, e ndjekur nga një rritje

shtesë me 9,474 në T-2, 353 në T-3 dhe 2,522 persona në T-4 të vitit 2011. Në sektorin publik, si dhe në sektorin e bujqësisë, punësimi ka mbetur pothuajse i pandryshuar përgjatë gjithë vitit. Numri i personave të papunë të regjistruar pësoi një rënie gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, duke shënuar një rënie prej 204 dhe 768 persona gjatë T-1 dhe T-2 të vitit 2011 në krahasim me tremujorin e mëparshëm dhe regjistroi rritje me 14 persona gjatë T-3 dhe më tej me 868 persona gjatë T-4 të vitit 2011. Norma e papunësisë qëndroi në nivelin 13.29 % duke shënuar një rënie të moderuar nga niveli 13.49 % që regjistronte në T-4 të vitit 2010.

Sektori monetar Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2011 ishte 3.5% duke mbetur brenda intervalit të synuar të politikës monetare prej 2%-4%. Norma mesatare e inflacionit për gjysmën e parë të vitit 2011 ishte pak mbi kufirin e sipërm prej 4 për qind, duke reflektuar kryesisht rritjen ndërkombëtare të çmimeve të ushqimit dhe karburanteve. Presioni inflacionit filloi të venitet në gjysmën e dytë dhe që në tremujorin e fundit të vitit 2011 deri vonë inflacioni ndodhet në nivele mjaft të ulëta.

Situata e sektorit financiar mbetet relativisht e shëndoshë. Gjatë vitit 2011 depozitat janë rritur me 11.5 për qind dhe kredia për ekonominë u rrit me 12.2 për qind në krahasim me vitin 2010. Kredia ndaj sektorit privat (jofinanciare korporata private), ka udhëhequr rritjen e kredisë totale me një rritje prej13 për qind në terma vjetorë dhe kryesisht kjo kredi është marrë për qëllime investimi, ndërsa kredia për individët ka mbetur në të njëjtin nivel të vitit 2010. Sektori bankar mbetet mjaft likuid, gjë e cila u reflektua edhe në një rënie të përgjithshme të normave të interesit gjatë vitit 2011. Niveli i kredive me probleme (NLP) ende mbetet një shqetësim serioz për sektorin financiar. Raporti i NPL-së arriti në 18.9% në fund të vitit 2011 nga 13.6 për qind që ishte në fund të vitit 2010. Në të njëjtën kohë kjo është e lidhur me rritjen e dispozitave të mbajtura nga ana e bankave në nivelin prej rreth 10 për qind të totalit të kredive nga 8 për qind që ishin në fund të vitit 2010 dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit mbetet në nivel mjaft të sigurt prej rreth 15 për qind, mbi nivelin minimal të detyrueshëm prej 12 për qind të kërkuar nga banka qendrore.



Ndryshe nga zhvillimet në kursin e këmbimit në vitin 2010, zhvlerësimi dhe vlerësimi i lekut gjatë vitit 2011 ishte i moderuar. Stabiliteti i lekut gjatë kësaj periudhe reflektohet nga qëndrueshmëria në bilancin ofertë-kërkese në tregjet monetare, stabilizimin e pritjeve në vlerën e monedhës kombëtare dhe të tkurrjes së bilancit tregtar. Në përputhje me këto zhvillime gjatë 2011-ës kursi nominal efektiv i këmbimit ka ndjekur një prirje të ngadalësuar zhvlerësimin. Në lidhje me ecurinë e lekut kundrejt valutave të huaja, euro dhe dollar amerikan, gjatë vitit 2011, zhvlerësimi mesatar i lekut ishte 1.8% kundrejt euros dhe një vlerësim prej 2.9% në terma vjetorë kundrejt dollarit amerikan. Efektet sezonale gjatë vitit 2011 ishin të moderuar për shkak të sjelljes së agjenteve të tregut, të cilët patën ndikimin e tyre në luhatjet e kërkesë-ofertës për valutë të huaj.

Sektori i jashtëm Pozicioni i jashtëm në vitin 2011 ka pasur një përkeqësim të lehtë në krahasim me vitin 2010. Bilanci i pagesave në vitin 2011 regjistroi një deficit të moderuar prej rreth 29 milionë euro nga një tepricë prej 179 milionë euro në vitin 2010. Megjithatë, stoku i rezervave të huaja ka mbetur në nivelin e rreth 1.8 miliard euro, i mjaftueshëm për të financuar rreth 4.4 muaj importe të mallrave dhe shërbimeve dhe kursi i këmbimit ka mbetur praktikisht i qëndrueshëm gjatë vitit 2011. Zgjerimi i deficitit të llogarisë korente me rreth 12.5 për qind në krahasim me vitin 2010 ka qenë kontribuesi kryesor në rezultatin e përgjithshëm negativ të bilancit të pagesave. Deficiti i llogarisë korente arriti në 12.2 për qind të PBB-së në vitin 2011 nga 11.3 për qind në vitin 2010. Deficiti tregtar u thellua me rreth 7.6 për qind në krahasim me vitin 2010 për shkak të një

ngadalësimi të konsiderueshëm të rritjes së eksporteve rreth 20 për qind krahasuar me rritjen prej 56 për qind në vitin 2010, si dhe për shkak të një përshpejtim të rritjes së importeve në 12 për qind nga 6.5 për qind që ishte në vitin 2010. Në kontrast të plotë me ecurinë shumë pozitive të përjetuar në vitin 2010, zhvillimet e këqija në sektorin e energjisë elektrike për shkak të kushteve të motit ishin një nga arsyet kryesore që çojnë në tregti të lartë dhe të deficitit të llogarisë korente në vitin 2011. Përveç kësaj, teprica e shërbimeve në vitin 2011 ishte më e ulët sesa vitin 2010 kryesisht për shkak të hyrjeve turistike më të ulëta dhe dalëse të larta turistike, e cila ishte një rezultat i pritshëm gjatë vitit të parë pa një regjim të vizave për banorët shqiptarë. Nga ana tjetër, pas tre vjet rresht reduktimi të konsiderueshëm, remitancat u stabilizua duke qëndruar në të njëjtin niveli si ato të vitit 2010, si dhe të ardhurat nga faktorët e prodhimit regjistruan një tepricë të vogël në krahasim me deficitin e vitit 2010 dhe 2009. Pavarësisht këtyre faktorëve hyrjet e investimeve të huaja direkte ishin rreth 6.5% më pak se në vitin 2010, teprica e llogarisë financiare u rritën me rreth 6.3 për qind në krahasim me vitin 2010, kryesisht për shkak të rritjes së konsiderueshme të kredive të huaja dhe depozitave që rrjedhin në Shqipëri.

Zhvillimet e fundit fiskale Nga të dhënat e Thesarit të Ministrisë së Financave, për vitin 2011, të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 330.5 miliardë lekë (shih tabelën 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin 3.9 për qind më të ulëta së parashikimi dhe 1.8 për qind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet totale arritën në 376.4 miliardë lekë (shih tabelën), 3.7 për qind më të ulëta së planifikimi dhe 3.8 për qind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet korente janë rritur mbi baza vjetore me 1.6 për qind, ndërsa shpenzimet kapitale janë rritur me 4.7 për qind.

Defiçiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në këtë 12-mujor në 45.9 miliardë lekë, 0.9 miliardë lekë më pak se planifikimi dhe 7.9 miliardë më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Deficiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brendshme (kryesisht huamarrje): 438 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e deficitit; 28.2 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brendshme neto. Financimi i huaj neto i deficitit ka qenë në nivelin 19.8 miliardë lekë, ose 3 miliardë më shumë se planifikimi.

Treguesit kryesorë të buxhetit të konsoliduar për vitin 2011

Miliardë lekë	Janar-dhjetor '10	Janar-dhjetor '11	Buxheti 2011
TË ARDHURAT TOTALE	324.7	330.5	344.1
SHPENZIMET TOTALE	362.8	376.4	390.9
Nga të cilat: SHPENZIMET KORENTE	300.9	305.7	314.8
Nga të cilat: SHPENZIMET KAPITALE	67.5	70.7	70.7
BALANCA FISKALE	-38.0	-45.9	-46.8
BALANCA PRIMARE	+3.6	-4.8	+0.03







Sipas nivelit të qeverisjes, në buxhetin e konsoliduar, të ardhurat e qeverisë qendrore përbëjnë për këtë periudhë 71.3 për qind të të ardhurave gjithsej; të ardhurat e qeverisjes lokale (nga taksa dhe tarifa) vetëm 3.6 për qind; ndërsa të ardhurat e fondeve speciale rreth 17.1 për qind të të ardhurave gjithsej në buxhetin e konsoliduar.

Nga këndvështrimi i klasifikimit ekonomik të të ardhurave, të dhënat tregojnë se Shqipëria ka një sistem tatimor që takson më shumë konsumin kundrejt të ardhurave dhe pasurisë. Të ardhurat nga tatimet mbi të ardhurat dhe pasurinë së bashku përbëjnë 15 për qind të të ardhurave gjithsej, ndërsa të ardhurat që mblidhen nga taksimi i konsumit (indirekt) përbëjnë gati gjysmën (47 për qind) të të ardhurave të buxhetit të konsoliduar.

Gjatë 2011-ës situata e mbledhjes së të ardhurave tatimore (që janë 92 për qind e totalit) pati përmirësim të ndjeshëm kundrejt një viti më parë, duke u ndikuar nga ri gjallërimi i aktivitetit ekonomik në vend, ndryshime në disa taksa dhe vazhdimësia në uljen e informalitetit. Të ardhurat tatimore u rritën me 5.3 për qind kundrejt një viti më parë; të ardhurat nga tatimet dhe doganat me 5.6 për qind; të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor pësuan 0.9 për qind ulje; të ardhurat në fondet speciale u rritën me 5.6 për qind; të ardhurat jo tatimore u ulën me 28 për qind.

Të ardhurat nga taksimi i konsumit (indirekt) arritën në 159.6 miliardë lekë, ndarë në 119 miliardë lekë nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe 40.4 miliardë lekë nga akcizat.

TVSH-ja mblidhet mbi mallrat e importuara dhe mbi transaksionet brenda vendit. TVSH në import ndikohet direkt nga vlera (CIF) e mallrave që importohen.

TVSH-ja e mbledhur në dogana mbi mallrat e importuara për vitin 2011 është 92.9 miliardë lekë, 9.6 për qind më shumë se viti 2010.

Gjatë 2011-ës importet janë dominuar nga mallrat e konsumit të përditshëm (ushqime, pije, duhan, lëndë djegëse), tekstile dhe këpucë, si dhe materiale ndërtimi dhe metale.

TVSH-ja mbi shitjet brenda vendit ka pësuar rënie të ndjeshme kundrejt një viti më parë, prej rreth 10.1 për qind. Sektorët e ekonomisë me rënie më të ndjeshme të pagesave të TVSH-së krahasuar me 2010-ën kanë qenë ndërtimi dhe telekomunikacioni, për arsye të qarta: sektori i ndërtimit ka më pak vlerë të shtuar gjatë 2011-ës, edhe si pasojë e reduktimit të investimeve publike; në sektorin e telekomunikacioneve ka pasur një nivel të lartë investimesh që kanë akumuluar TVSH-në të kredituesshme, si dhe ulje të tarifave të telefonisë celulare. Gjatë 2011-ës është rritur ndjeshëm

dhe niveli i TVSH-së së rimbursuar, sepse eksportet kanë qenë pjesë dominuese e aktivitetit ekonomik në vend dhe siç dihet Shqipëria takson eksportet me normë TVSH-je zero.

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën janar-dhjetor 2011 arritën në rreth 40.4 miliardë lekë; ose -2.1 % më pak se parashikimi sipas planit në buxhetin e rishikuar; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga kjo taksë janë rritur në masën 4.2 për qind. Akciza pësoi ndryshime të ndjeshme në qershor të vitit 2010: u ul akciza mbi kafen e papjekur (nga 70 lekë në 30 lekë për kg), u hoqën nga lista e mallrave me akcizë lëngjet e frutave dhe pijet freskuese, në grupin e nënprodukteve të naftës shtohet artikulli "naftë virgin" me nivel akcize 50 lekë për litër; u shtuan në listën e mallrave me akcizë: fishekzjarrët, gomat, pilat dhe bateritë primare, ambalazhet; ndryshoi taksimi i llambave inkandeshente nga *ad valorem* në shumë fikse. Në fillim të vitit 2011 pati rritje të akcizës mbi cigaren, nga 50 lekë në 70 lekë për paketë. Ndërsa ndryshimi më i fundit lidhet me ndryshimin e akcizës për disa mallra, si: birra, solar mazut dhe koks nafte.

Të ardhurat nga akciza që mbledhin doganat ka një rënie me 1 për qind kundrejt një viti më parë dhe 2.4 për qind më pak se parashikimi për periudhën. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birrës së importuar, si dhe të mallrave të tjera që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës (siç janë mallrat që i janë shtuar listës së mallrave të akcizës).

Taksimi direkt Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 28 miliardë lekë, ose 3.1 për qind më shumë se një vit më parë. Për të kuptuar më mirë ecurinë e këtij taksimi, zbërthejmë të dhënat sipas burimeve të ndryshme të të ardhurave individuale të taksueshme. Të ardhurat nga tatimi mbi pagën e të punësuarve të sektorit publik kanë qenë rreth 8.8 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 4.2 për qind; të ardhurat nga tatimi mbi pagën në sektorin jo-publik kanë qenë 8.9 miliardë lekë me rritje vjetore prej 11.5 për qind, çka tregon rritje të indikatorit "*wage bill*", që ndikohet nga niveli i punësimit dhe niveli i pagave; të ardhurat nga interesat për periudhën janë në nivelin 3.2 miliardë lekë, pak a shumë në të njëjtin nivel me një vit më parë.

Të ardhurat nga taksimi individual sipas burimit të të ardhurave

Të ardhura, miliardë lekë	12-mujor 2010	12-mujor 2011	Ndryshimi %
Tatimi mbi të ardhurat personale gjithsej	27	27.9	+3.1
Paga sektori publik	8.4	8.8	+4.2
Paga sektori jopublik	8.0	8.9	+11.5
Interesa	3.0	3.2	+4.6
Dividendë	1.3	1.4	+9.3
Shitje pasuri e paluajtshme	2.35	1.2	-49.3
Të tjera	3.95	4.4	11.4

Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 12-mujorin 2011 arritën në rreth 19.7 miliardë lekë nga 17.6 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rritje të ndjeshme prej 12 për qind dhe -6.7 % më pak se plani i rishikuar.

Në rezultatin e të ardhurave për tatim fitimin për këtë vit ka ndikuar derdhja e tatim fitimit nga ndërmarrjet shtetërore, krahasuar me një vit më parë është rritur në masën 101.1% ose 1.1 miliardë lekë më shumë. Pesha e tatim-fitimit nga ndërmarrjet shtetërore në total është vetëm 12%. Për sa i përket sektorit privat të ardhurat nga tatim fitimi janë rritur me vetëm 5.8 % duke pasur parasysh që sektori privat zë rreth 88% të peshës specifike në këtë taksë.

Rritjen më të madhe në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë e ka e ka shënuar sektori i prodhimit me 30.1% e pasuar nga sektori i tregtisë dhe shërbimeve me përkatësisht 25.1% dhe 12.9%. Me ulje janë sektori i ndërtimit dhe ai i transportit me përkatësisht -20 për qind dhe me -11 për qind.

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 2.57 miliardë lekë, me rritje vjetore prej 10.9 për qind; duke qenë 38.9 për qind më lartë se parashikimi sipas buxhetit të rishikuar. Këtu theksojmë se shifra 2.257 miliard lekë nuk përfshin edhe vlerën e taksës që nuk është mbledhur për rimbursimin e çmimit të kasave. Kjo vlerë rimbursimi arrin në rreth 465 milionë lekë, të përballuara nga fondi i kontingjencës së parashikuar në buxhetin e vitit 2011.

Taksimi i pasurisë Për qëllime analize, këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat, mbi tokën bujqësore dhe taksën e kalimit të pasurisë së paluajtshme. Për 12-mujorin taksat mbi pasurinë arrijnë

në 1.94 miliardë lekë nga 10.9 miliardë të parashikuara dhe 2.4 për qind më të larta se një vit më parë.

Taksat nacionale Të ardhurat nga taksat nacionale në total për periudhën, janë 21.4 miliardë lekë nga 22.3 miliardë lekë të parashikuara për periudhën janar-dhjetor. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash ka pësuar një rritje prej 16.9 për qind. Muaji shtator ishte muaji i pare i zbatimit të taksave të reja të hyra në fuqi në fund të gushtit. Ecuria e taksave të reja do të shikohen në vitin 2012.

Taksa doganore Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën janar-dhjetor janë rreth 6.85 miliardë lekë, -12.3 për qind më pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 424 milionë lekë, ose -5.8 për qind. Niveli mesatar i taksës doganore për këtë periudhë është 1.59 për qind nga 1.74 për qind në vitin 2010, duke kontribuar kështu dhe në uljen e të ardhurave nga taksat doganore.

Të ardhura të tjera nga pushteti vendor Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën janar-dhjetor arritën në 11.8 miliardë lekë nga 15.3 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e 2011-ës, ndërsa kundrejt 12-mujorit të vitit 2010 të ardhurat janë ulur me 107 milionë lekë (rreth -0.9 për qind më pak). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogël dhe taksat mbi pasurinë për të cilat folëm më lart) kanë mbledhur rreth 7.3 miliardë lekë nga 2.5 miliardë të parashikuara, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë me vitin e kaluar këto taksa kanë pësuar një rënie prej -5.3 për qind.

Të ardhurat e fondeve speciale Të ardhurat në fondet speciale për periudhën janar-dhjetor 2011 arritën në 56.6 miliardë lekë, me një rritje prej 5.6 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe -2.4 për qind më pak se parashikimi sipas buxhetit të rishikuar. Ky grup të ardhurash përbën rreth 19 për qind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, rreth 55 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 1.6 miliardë lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 48.8 miliardë lekë, me rritje vjetore 8.4 për qind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 6.15 miliardë lekë, -4.4 për qind më pak se 12-mujori i një viti më parë.

Kuadri makroekonomik afatmesëm

Parashikimi i treguesve makroekonomik afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërëse të kuadrit makroekonomik është bazuar në teknikat analitike të programimit financiar. Për këtë qëllim janë ndërtuar disa skenarë të mundshëm të ecurisë makroekonomike të vendit, rezultatet e të cilëve i janë nënshtruar një analizë krahasuese të hollësishme për të arritur në skenarin bazë makroekonomik. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik, mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukturore qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të aktorëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili duket si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të prodhuara prej institucioneve si, Instituti i Statistikave, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Eurostat, Banka Qendrore Europiane, etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, testimit, analizat krahasuese, statike, dinamike, e pasi kryhen një sërë testesh konsistence, skenari bazë i përftuar synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme e maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale. Objektivat themelorë të miksit të politikave monetare e fiskale gjatë tre viteve në vijim me anë të të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimit sa më të shpejtë drejt nivelit mesatar të mirëqenies të Bashkimit Europian, janë:

- Borxhi publik total në fund të çdo viti fiskal nuk do të jetë më i lartë se 60% e produktit të brendshëm bruto.

- Huamarrja totale neto për vitin fiskal 2013 nuk do të jetë më e lartë se 3% e produktit të brendshëm bruto.

- Huamarrja totale neto për vitet fiskale 2014-2015 nuk do të jetë më e lartë se 2.5% e produktit të brendshëm bruto.

- Shpenzimet kapitale të buxhetit gjatë çdo viti fiskal do të jenë të paktën sa huamarrja totale neto e këtij viti.

Këta objektiva fondamentalë përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal brenda të cilave përcaktohen projeksionet për të gjithë variablat e tjerë makroekonomik.

Projeksionet për treguesit kryesorë makroekonomik për periudhën 2013-2015 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Sektori real

PBB: Kërkesa agregate

Konsumi final parashikohet të rritet në terma reale me një normë vjetore mesatare prej 2.9% gjatë periudhës afatmesme (2013-2015). Rritja e konsumit final në 2013 është parashikuar që të vazhdojë të rritet me ritme më të larta, 2.9 %, nga 2.1 që ishte në vitin 2012 dhe 1.9% që ishte në vitin 2011. Në dy vitet e ardhshëm rritja e konsumit parashikohet të jetë në nivelet 2.9% dhe 2.8% për 2014 dhe 2015, duke kontribuar në rritjen e PBB-së me 2.5 pp (gjatë të dy viteve) nga kontributi prej 1.9 pp që ishte në vitin 2011.

Formimi bruto i kapitalit fiks gjatë 2013-2015 është parashikuar të përjetojnë një rritje mesatare vjetore reale prej 5.1%. Kontributi i tij në rritjen e PBB-së është parashikuar që të jetë në një mesatare vjetore prej 1.6 pp gjatë 2013-2015. Ky parashikim është në përputhje me zhvillimet e fundit pozitive të ekonomisë, si dhe pritshmëritë nga ambienti i jashtëm dhe i brendshëm për periudhën afatmesme në vazhdim.

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
					Para.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	3.17	3.19	3.20	3.21	3.22	3.23	3.23	3.25
Norma e inflacionit (mesatar)	%	3.4	2.3	3.6	3.5	3.0	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	4.7	2.3	3.5	3.1	1.1	1.2	1.2	1.3
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	83.9	95.0	103.9	100.9	102.0	102.5	104.0	104.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	122.8	131.6	137.7	140.5	139.7	140.0	140.0	140.5
Rritja reale e PBB	%	7.5	3.3	3.9	3.0	4.3	5.0	4.9	5.1
PBB	Lek miliardë	1,089.3	1,151.0	1,238.1	1,314.7	1,385.0	1,471.6	1,561.5	1,661.7
PBB	USD miliardë	13.0	12.1	11.9	13.0	13.6	14.4	15.0	16.0
PBB	Euro miliard	8.9	8.7	9.0	9.4	9.9	10.5	11.2	11.8
PBB për banor	Lek mijë	343.6	360.4	387.5	410.1	430.5	455.8	483.1	511.9
PBB për banor	USD	4,096.1	3,793.9	3,728.6	4,064.2	4,220.4	4,446.7	4,644.9	4,922.0
PBB për banor	Euro	2,799.0	2,738.6	2,814.3	2,918.5	3,081.4	3,255.6	3,450.5	3,643.3
PBB për banor	USD-PPP	7,991.3	8,380.9	9,011.9	9,537.0	10,011.1	10,599.6	11,234.2	11,904.3
Norma e papunësisë	%	12.7	13.8	13.5	12.9	12.1	11.4	10.6	9.4
Të ardhurat totale	% të PBB	26.7	26.0	26.2	25.0	25.7	25.7	25.8	25.9
Shpenzimet totale	% të PBB	32.3	33.0	29.3	28.4	28.7	28.6	28.3	28.3
Bilanci i përgjithshëm fiskal	% të PBB	-5.5	-7.0	-3.1	-3.3	-3.0	-3.0	-2.5	-2.5
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-2.7	-3.9	0.3	-0.2	0.6	0.7	1.1	1.1
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	3.1	1.3	2.4	1.8	2.1	1.9	2.0	2.1
Huamarrje totale neto	% të PBB	4.9	4.6	3.1	3.4	3.0	2.9	2.4	2.4
Borxhi Publik Total	% të PBB	54.7	59.3	57.8	58.9	59.6	59.5	59.0	58.1
Borxhi publik i qeverise se pergjithshme	% të PBB	51.3	55.3	54.1	55.2	55.4	55.1	54.3	53.5
Borxhi publik jashte treguesve fiskale	% të PBB	3.4	4.0	3.7	3.7	4.2	4.4	4.7	4.6
Llogaria korente	% të PBB	-15.6	-15.1	-11.7	-12.5	-11.7	-10.9	-8.9	-8.1
Bilanci i mallrave	% të PBB	-26.6	-24.3	-21.1	-21.4	-18.3	-16.7	-14.2	-12.7
Bilanci i shërbimeve	% të PBB	0.8	2.0	2.0	1.4	3.2	3.1	3.5	3.4
Bilanci i Pagesave	% të PBB	2.1	-0.3	2.0	0.7	1.8	1.6	2.7	3.2

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

Rritja e investimeve private reale është parashikuar në 5.1% në 2013, 5.7% në 2014 dhe 5.5% në 2015. Parashikimi afatmesëm i investimeve private merr parasysh përmirësimin e ndjeshëm të likuiditetit në sektorin financiar, si dhe trendin rritës në të ardhmen afatmesme, përshpejtimin e rritjes së PBB-së gjatë vitit 2013 në drejtim të rritjes potenciale (ose rritja mesatare gjatë dhjetë viteve të fundit), rritja e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe përmirësimit të klimës së bizneseve. Supozimet janë marrë në lidhje me një përmirësim në perspektivën makroekonomike globale, si dhe veçanërisht perspektivën e BE-së dhe partnerëve kryesorë ekonomikë të Shqipërisë, përbëjnë një variabël tjetër të rëndësishëm për parashikimin e investimeve private. Flukset e larta hyrëse të investimeve të huaja direkte dhe kërkesa e lartë për mallrat dhe shërbimet shqiptare janë dy nga kanalet kryesore që parashikojmë që do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pozitiv për investimet e ardhshme private.

Eksporti neto i mallrave dhe shërbimeve ka shkaktuar një deficit përgjatë periudhës 2000-2009 duke u thelluar çdo vit me një mesatare prej 10 % (nga viti në vit). Më 2010-ën bilanci i mallrave dhe shërbimeve ka shënuar një nga vlerat e saj më të ulëta prej 13.3 % krahasuar me 2009 për shkak të një përkeqësimi të marrëdhënieve tregtare me shtetet fqinje të BE-së dhe sidomos me Greqinë dhe Italinë, të cilët konsiderohen si partnerët kryesorë të eksportit shqiptar. Megjithatë gjatë vitit 2011 ky deficit shënoi një përmirësim shumë të lartë, duke e sjellë në normalitet ecurinë tregtare të vendit. Ky përmirësim i madh në kërkesën e jashtme neto gjatë vitit 2011 ishte shtysa kryesore e rritjes me 3.0 % të PBB-së, duke kontribuar me 0.1 pikë përqindjeje.

Për periudhën afatmesme në vazhdim parashikojmë një situatë të qëndrueshme të bilancit neto të mallrave dhe shërbimeve edhe pse ajo është parashikuar të ndjekë një trend më të moderuar. Kështu gjatë vitit 2013 parashikohet një tkurrje e deficitit të mallrave dhe shërbimeve me 4.4 %, me rreth 6 % në 2014 dhe për t'u zvogëluar sërish me 5.3 % në vitin 2015. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve parashikohet të rritet me një normë mesatare vjetore prej 10.2 % gjatë 2013-2015 dhe importi është parashikuar të rritet me një mesatare prej 6.2 %. Deficiti i mallrave dhe shërbimeve duke marrë në konsideratë (çmime korente) të PBB-së parashikohet të ulet gradualisht nga 16.7 % të PBB-së në 2013 në 14.2 % të PBB-së në 2014 dhe 12.7 % të PBB-së në 2015. Të dhënat e parashikuara të kërkesës së huaj pasqyrojnë supozimet për perspektivën afatmesme rritëse globale dhe veçanërisht të vendeve të BE-së dhe partnerëve kryesore tregtare shqiptare, si dhe fitimet e pritshme të konkurrueshmërisë të mallrave shqiptare dhe shërbimeve (veçanërisht shërbimet e turizmit). Gjithashtu, parashikojmë që duke marrë në konsideratë që nuk do të ketë përkeqësime të situatës hidroenergjisë gjatë një periudhe afatmesme, rritje të përgjithshme në efikasitetin e gjenerimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në rrjet.

Ndryshimet në inventar, janë marrë me një kontribut neutral (zero pp) në kërkesën agregate dhe rriten reale të PBB-së.

PBB: (Oferta agregate)

Parashikimet e kërkesës agregate dhe komponentëve të saj të paraqitura më sipër janë në përputhje me parashikimet e ofertës agregate ndarë sipas sektorëve të saj kryesorë.

Prodhimi bujqësor, duke supozuar kushte normale klimatike, parashikohet të rritet me normën historike të tij rritje mesatare prej rreth 3.5 % në vit për periudhën e ardhshme 2013-2014.

Prodhimi industrial, duke përfshirë industrinë nxjerrëse dhe prodhuese, është parashikuar të rritet mesatarisht me 5.8 % në vit për periudhën afatmesme në vazhdim.

Ndërtimi për periudhën në vazhdim afatmesme (2013-2014) është parashikuar të ketë një rritje mesatare prej 3.0 % në vit.

Shërbimet për periudhën e ardhshme afatmesme (2013-2014) janë parashikuar të rriten mesatarisht me 5.6 % në vit. Kontributin kryesor pritet ta japin transporti, tregtia hotel dhe restorant, si dhe postë-telekomunikacioni.

Bazuar në parashikimet e mësipërme të kërkesës dhe ofertës agregate, skenari bazë i paraqitur parashikon një rritje reale të PPB-së prej 4.3 % në 2012-ën, 5 % në 2013-ën dhe 4.9 % në 2014-ën.

Inflacioni, për periudhën 2013-2015, parashikohet të luhatet brenda kufijve 2-4 % të vendosur të Bankës së Shqipërisë, ku mesatarja e tij parashikohet në 3 % gjatë kësaj periudhe. Deficiti tregtar i shprehur në terma të PBB-së është parashikuar që të reduktohet gradualisht nga 16.7 % të PBB-së në 2013-ën në 12.7 % për vitin 2015.

Shërbimet parashikohet të kenë një bilanc pozitiv në vazhdimësi. Bilanci i shërbimeve, i shprehur në terma të PBB-së, parashikohet të rritet gradualisht për periudhën e ardhshme 3-vjeçare, duke arritur në 3.1 % të PBB-së në 2013-ën, në 3.5 % në vitin 2014-ën dhe 3.4 % që është parashikuar në 2015.

Transfertat neto shprehur në terma të PBB-se janë parashikuar për të ndjekur një ulje graduale përgjatë periudhës së ardhshme dhe të arrijnë në 7.1 % të PBB-së në 2013-ën, në 6.8 % të PBB-së në 2014-ën dhe 6.4 % të PBB-së në vitin 2015. Kjo tkurrje në transfertat neto do të vijë si pasojë e ngadalësimit të transfertave nga remitancat.

Në bazë të këtyre parashikimeve, si dhe duke marrë gjithashtu parasysh burimet e financimit, deficiti i llogarisë korente është parashikuar të ndjekë një nivel të qëndrueshëm për një periudhë afatmesme. Ky deficit pritet të zvogëlohet gradualisht në vitet e ardhshme duke arritur në 10.9 % të PBB-së në 2013-ën në 8.1 % të parashikuar për 2015-ën.

Investimet e huaja direkte parashikohet të jenë të qëndrueshme në rreth 9.6 % të PBB-së gjatë viteve 2013 dhe 2015. Parashikojmë që IHD të arrijnë nivel prej 9.5 % të PBB-së në vitin 2013 nga 9.6 % e PBB-së në 2014 dhe 9.7 % në vitin 2015 ndryshe nga investimet në vitet 2007-2010, ku një pjesë e konsiderueshme e IHD-ve kanë qenë në formën e privatizimit të ndërmarrjeve publike, për vitet e ardhshme 2013-2015 shumica e tyre do të jetë e tipit "green - field".

Politikat tatimore dhe parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme

Projektkodi i ri doganor, i cili po hartohet në përputhje të plotë me rregulloren 450/2008 të Bashkimit Europian ka si qëllim kryesor lehtësimin e biznesit, garantimin e një niveli të lartë të sigurisë dhe mbrojtjes për t'ju përgjigjur në këtë mënyrë sfidave me të cilat do të përballet Shqipëria me realitetin ekonomik të Bashkimit Europian. Projekt legjislacioni doganor synon modernizimin dhe thjeshtëzimin e rregullave doganore përmes një mjedisi doganor pa letër si për autoritetin doganor ashtu edhe për operatorin ekonomik, përdorimin e mjeteve dhe teknologjisë moderne të komjuterizimit, të cilat të gjitha këto përbëjnë bazën për një procedurë zhdoganimi të thjeshtë dhe efiçente. Kodi i ri doganor bazuar veçanërisht në sisteme kompjuterike të integruara ofron:

- thjeshtimin e rregullave doganore;
- përmirësimin e kontrolleve doganore, të cilat parësisht kryhen bazuar në një analizë risku si pjesë e kornizës së menaxhimit të riskut;
- lehtësimin e procedurave të zhdoganimit, të cilat do të jenë plotësisht të komjuterizuara dhe do të ofrojnë maksimumin e thjeshtëzimeve;
- efikasitet në zbatimin e procedurave doganore, të cilat janë riorganizuar në "procedura speciale" duke mundësuar një ristrukturim të tranzitit (kombëtar dhe të jashtëm), magazinimit (magazinimi i përkohshëm, magazinimi doganor, zonat e lira), përdorimit të veçantë (pranimi i përkohshëm dhe *end-use*) dhe përpunimit (përpunimi aktiv dhe pasiv).

Gjatë vitit 2012, Ministria e Financave është në përputhje me programin e qeverisë shqiptare për formalizimin e ekonomisë, luftën ndaj evazionit fiskal dhe kontrabandës, përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorit, do të fokusohet në dhënien me koncesion të dy shërbimeve të rëndësishme publike në dy sektorë strategjitikë për mbledhjen e të ardhurave:

1. Dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në RSH;
2. Dhënien me koncesion e shërbimit të skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera.

